



[www.hap.org.al](http://www.hap.org.al)

## Relacion i Politikave

# Mbërritja pranë komuniteteve rurale me anë të parandalimit të SJT-ve dhe promovimit të shëndetit në Shqipëri: Projekti zviceran Shëndet për të Gjithë (HAP)

*Dr Kate Molesworth, Swiss Centre for International Health*

### Sfidat e reja shëndetësore në Shqipëri

Si në shumë vende të botës, edhe në Shqipëri ka rritje të përkeqësimit të shëndetit, paaftësisë dhe vdekjeve të parakohshme si pasojë e sëmundjeve jo të transmetueshme (SJT) të tilla si kanceret dhe sëmundjet kardio-vaskulare<sup>iii</sup>. Në themel të kësaj tendence është rritja e sjelljeve të rrezikshme të parandalueshme, duke përfshirë aktivitetin e pamjaftueshëm fizik, konsumin dhe ekspozimin pasiv ndaj tymit të duhanit si dhe konsumin e tepërt të alkoolit, së cilave u shtohen rreziqet që rrjedhin prej një diete të pasur me mish, yndyrna, kripë dhe sheqer dhe të varfër në druthëra të plota, fruta dhe perime. Ky relacion politikash paraqet nisma dhe risi të ndërmarra nga projekti zviceran “Shëndeti për të Gjithë (HAP)” lidhur me ndërgjegjësimin ndaj SJT-ve. Disa nga këto ishin qasjet e para ballë për ballë që synonin komunitetet rurale dhe peri-urbane në Shqipëri.



### Përgjigja e projektit HAP

Projekti “Shëndet për të Gjithë (HAP)”, i mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatuar nga Instituti Zviceran i Shëndetit Tropikal dhe Publik (S`iss TPH), Terres des Hommes dhe Save the Children në partneritet me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) kontribuon në përgjigjen kombëtar ndaj barrës së lartë të sëmundjeve të parandalueshme duke forcuar sistemin shëndetësor për të ofruar promovimin e efektshëm të shëndetit dhe edukimin shëndetësor me qëllim fuqizimin e individëve, familjeve dhe komuniteteve për të bërë zgjedhje të shëndetshme dhe zvogëluar riskun e zhvillimit të SJT-ve duke përshtatur sjelljet dhe modelet e konsumit.

Në këtë mënyrë, në Fazën 1 (2015-2019) HAP mbështeti qeverinë shqiptare me adresimin e sëmundjeve të mëposhtme në qarqet Fier dhe Dibër:

- sëmundjet kardiovaskulare;
- diabeti;
- kanceret;
- sëmundje kronike të frymëmarrjes.

Për ta bërë këtë, qasjet e projektit janë përqendruar në aktivitete që synojnë parandalimin nëpërmjet **ndryshimit të sjelljeve** që lidhen me **hipertensionin, mbipesaën/obezitetin, ngritjen e glukozës në gjak dhe rritjen e kolesterolit** në Shqipëri, konkretisht:

- konsumi i duhanit;
- pasiviteti fizik;
- dieta jo të shëndetshme;
- përdorimi i dëmshëm i alkoolit.

Megjithëse komunitete të tëra janë përfshirë në aktivitetet e HAP, projekti ka në qendër veçanërisht nxënësit dhe adoleshentët.

## Qasjet e promovimit të shëndetit

Projekti ka përdorur një sërë qasjesh që synojnë nivele të ndryshme nga riorientimi i mjedisit politik për të mbështetur edukimin shëndetësor deri te puna e drejtpërdrejtë me komunitetet dhe punonjësit e tyre të kujdesit shëndetësor parësor. Këtu janë përfshirë katër nisma kryesore:

### Rezultatet kryesore

- Taketa trajnuese për Kabinetet e Promocionit Shëndetësor.
- Plani Kombëtar i Veprimit për Promovimin e Shëndetit 2017-2021
- Parandalimi i hipertensionit, depistimi dhe shtrirja e kontrollit për 7058 anëtarëve të komunitetit.
- Më shumë se 600 nxënës dhe 57 mësues janë përfshirë në iniciativën e Shkollave për Promovimin e Shëndetit.

### 1. Kabinetet për krijimin e kapaciteteve dhe zhvillimin e politikave

Në vitin 2015, në përgjigje të nevojës për forcimin e nivelit të lartë, promovimin e shëndetit pjesëmarrës të komunitetit, aparenca, HAP filloi duke punuar me Institutin e Shëndetit Publik (ISHP) për të nënshkruar një paketë trajnime për Kabinetet e Promocionit Shëndetësor të Dibrës dhe Fier brenda Drejtorive të Shëndetit Publik. Me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHSP), HAP gjithashtu ndihmoi në krijimin e një zhvillimi të mjedisit politik mbështetës, në formën e Planit Kombëtar të Veprimit për Promovimin e Shëndetit 2017-2021.



Figure 1. Screening of hypertension during the Measurement Month.

### 2. Ndërgjegjësimi dhe kontrolli i hipertensionit

Hipertensionit është një nga shkaqet kryesore të vdekjes së parakohshme dhe shëndetit të keq në Shqipëri. Në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Promovimin e Shëndetit dhe Shoqërinë Ndërkombëtare të Hipertensionit, HAP mbështeti ISHP-në, Kabinetet e Promocionit Shëndetësor në Dibër dhe Fier, si dhe përzgjodhi qendrat shëndetësore lokale për të planifikuar dhe zbatuar Muajin e Matjes së Majit në vitin 2018. Projekti ofroi mbështetje logjistike për partnerët zbatues dhe materiale të shtypura informuese dhe komunikuese (IEC). Në bashkitë Peshkopi, Bulqizë, Klos, Lushnjë, Roskovec dhe në qytetet e Tiranës dhe Durrësit, personeli shëndetësor i nivelit loakl, së bashku me Kabinetet e Promocionit Shëndetësor (PSH), promovuan parandalimin dhe kontrollin e hipertensionit nëpër qendrat lokale shëndetësore. Prezantimet mbi faktorët e riskut të hipertensionit dhe masat parandaluese u ndoqën nga 7058 anëtarë të komunitetit, 70% e të cilëve ishin femra dhe 40% meshkuj mbi moshën 18 vjeç. Përveç marrjes së informacionit të shtypur mbi faktorët e riskut të hipertensionit, pjesëmarrësve iu mat tensioni i gjakut nga stafi i Qendrës Shëndetësore dhe ata me hipertension u referuan për trajtim.

### 3. Nisma e promovimit të shëndetit nëpër shkolla


Shkollat janë një mjedis i rëndësishëm për të komunikuar me fëmijët me anë të informacionit dhe udhëzimeve për promovimin e shëndetit për të forcuar edukimin e tyre shëndetësor në një fazë të hershme të jetës dhe përpara se të bëhen vetë prindër. HAP angazhoi fëmijë, prindër dhe mësues në iniciativën e promovimit të shëndetit në shkollë me anë të sportit dhe ushqimit të shëndetshëm. Në këtë mënyrë, 1500 nxënës, prindërit e tyre dhe 120 mësuesit e tyre u përfshinë në aktivitete shkollore, përfshirë panairë ushqimi në qarkun e Dibrës.

### 4. Fushatat kombëtare në masmedia

Dy spote televizive mbi hipertensionin dhe ndërgjegjësimin mbi diabetin u prodhuan nga HAP dhe u transmetuan gjatë tre fushatave në 2016 dhe 2017 nga kanalet televizive kombëtare dhe rajonale me mbulim të gjerë: për shembull, u vlerësua se fushata e nëntorit 2017 për ndërgjegjësimin ndaj diabetit arriti në 88 000 persona).


## 5. Përshëndetje/Karvani shëndetësor

Në përgjigje të nevojave të identifikuar në komunitet dhe në Qendrat Shëndetësore, projekti në vitin 2018 zhvilloi dhe pilotoi një model inovativ me dy drejtime të promovimit në komunitet dhe në kujdesin shëndetësor parësor (KSHP) të njohur si “Përshëndetje” në shqip dhe “Karvani i Shëndetit” në anglisht. Kjo fushatë e lëvizshme angazhoi individë, familje dhe komunitete në veprimtari të rëndësishme, me pjesëmarrje të publikut për të rritur njohuritë lidhur me faktorët e riskut, si dhe përfitimet prej ndryshimit të sjelljes për të parandaluar sëmundjet dhe për të rritur kërkesën për shërbime kontrolli të SJT-ve. Në të njëjtën kohë, HAP zhvilloi materiale dhe udhëzime për të forcuar stafin lokal të KSHP-ve në udhëheqjen dhe mbështetjen e komuniteteve drejt parandalimit, zbulimit, trajtimit të hershëm dhe përgjigjes ndaj emergjencave. Modeli, nën mbikëqyrjen dhe monitorimin e ISHP-së dhe Kabinetet e Promocionit Shëndetësor, tregohet më poshtë:



Sikurse e ilustron figura më poshtë, modeli “Përshëndetje” përfshinte një aktivitet komunitar lëvizës që përbëhej prej pesë stacionesh ndërvepruese me temë SJT-të; secili stacion drejtohej nga lehtësues meshkuj e femra të trajnuar nga një partner i zgjedhur zbatues lokal dhe 15-20 lehtësues në total përfshiheshin për çdo aktivitet në komunitet. Këto stacione vizitoheshin me radhë nga grupe dhe familje dhe shërbenin si arena të efektshme për angazhimin e adoleshentëve dhe të të rinjve. Ndërsa adoleshentët, të rinjtë dhe të rriturit


në stacionet tematike morën pjesë në aktivitetet e edukimit shëndetësor dhe rritjen e njohurive mbi risqet që lidhen me tymin e duhanit, dietën jo të shëndetshme, pasivitetin fizik dhe alkoolin, fëmijët e vegjël u argëtuan me lojëra dhe aktivitete që përçonin mesazhe të thjeshta shëndetësore nga dy animatorë të trajnuar, të cilët gjithashtu lehtësuan lëvizjen e njerëzve nëpër aktivitetet. HAP jo vetëm që zhvilloi këtë model inovativ, por hartoi të gjitha manualat e lehtësuesve, mesazhet kryesore, skaletat dhe përktheu e përshtati sipas kontekstit lokal materialet informuese, edukative dhe të ndryshimit të sjelljes.



The Përshëndetje model comprising five NCD risk topic stations and the local Health Centre station.



The Përshëndetje model comprising five NCD risk topic stations and the local Health Centre station.



HAP self-assessment cards

Ndërsa njerëzit lëviznin gjatë circuitit 1.5 - 2 orë të fushatës “Përshëndetje”, ata u nxitën që të plotësojnë formularët e vetëvlerësimit për të vlerësuar risqet e sjelljes dhe stilit të jetës. Pasi i kishin vizituar që të gjitha stacionet tematike, pjesëmarrësit orientoheshin drejt stacionit të çdo qendre shëndetësore lokale që lehtësohej nga personeli i trajnuar shëndetësor për të diskutuar risqet e evidentuara nga vetëvlerësimi, për të lënë orare vizite dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të ngritura nga stacionet tematike të SJT-ve. Për një angazhim të vazhdueshëm me komunitetet në informimin shëndetësor për SJT-të, HAP ka hartuar materiale dhe udhëzime për njohjen e emergjencave të tilla si: goditjet në tru, arresti kardiak dhe emergjenca diabetike që t’i përdorin Qendrat Shëndetësore për të përmirësuar më tej njohuritë e komunitetit dhe për të marrë masat e nevojshme për t’u shpëtuar jetën anëtarëve të familjeve dhe komunitetit.

### Rezultatet kryesore

- Modeli interaktiv për informacionin shëndetësor lidhur me SJT-të është zhvilluar, testuar dhe pilotuar në komunitet.
- Shërbimet lokale të KSHP-së janë forcuar për të udhëhequr promovimin e shëndetit në komunitet dhe mbikëqyrjen dhe monitorimin e tij.
- Anëtarët e komunitetit janë përfshirë me shërbimet lokale të KSHP - disa për herë të parë në jetën e tyre.
- Personeli shëndetësor lokal është mbështetur me dokumente udhëzuese të përshtatura dhe materiale për ndryshimin e sjelljes për të zvogëluar risqet nga SJT-të.
- Manualët dhe udhëzimet për njohjen dhe përgjigjen e duhur ndaj emergjencave të SJT-ve janë ofruar.
- 4850 të rritur dhe adoleshentë janë angazhuar në uljen e riskut të SJT-ve dhe janë lidhur me shërbimet e KSHP-së.
- 51% e pjesëmarrësve kanë qenë meshkuj dhe 49% femra.

## Numri i personave të përfshirë në fushatën e promovimit të shëndetit “Përshëndetje”

Gjatë zhvillimit të fushatës “Përshëndetje” 2018-2019 u zhvilluan aktivitete në terren pranë komunitetit në 33 fshatra në Dibër dhe Fier, duke arritur tek rreth 4850 të rritur dhe adoleshentë: nga të cilët 2468 ishin meshkuj dhe 2380 femra. 40% e të gjithë pjesëmarrësve ishin në intervalin moshor 14-35 vjeç.

## Aspekti ekonomik i qasjes “Përshëndetje”

Mbërritja pranë komunitetit, për nga vetë natyra e saj është e kushtueshme. Çdo veprimtari shëndetësore që shkon pranë 150 adoleshentëve, të rinjve dhe të rriturve kushton mesatarisht 3600 USD ose 25 dollarë për çdo anëtar të publikut pranë të cilit ka mbërritur. Këtu përfshihen të gjitha shpenzimet e zhvillimit të një aktiviteti të vetëm dhe shpenzimet fillestare si edhe shpenzimet e përsëritura dhe ato të vënies në zbatim. HAP vlerëson se Qeveria Shqiptare ose agjenci të tjera mund të zbatojnë modelin “Përshëndetje” me pak shpenziome deri në 2700 USD për çdo aktivitet pasi aspektet e mëposhtëm me një vlerë prej 30 000 USD janë zhvilluar dhe paguar nga HAP dhe janë në dispozicion për përdorim të rregullt në të ardhmen; Dokumentet dhe termat e referencës të trajnimit dhe orientimit të fushatës “Përshëndetje” për partnerët zbatues; Krijimi i posterave dhe materialeve informuese, edukative dhe komunikuese për pesë stacione SJT; Hartimi i broshurave për ndryshimin e sjelljes dhe skadat e vlerësimit të riskut; Dokumente orientuese për qendrat shëndetësore në fushatat e edukimit shëndetësor të komunitetit dhe ato të promovimit të shëndetit për adresimin e SJT-ve; Hartimi i posterave dhe materialeve informuese, edukative dhe komunikuese për komunitetet lidhur me njohjen dhe përgjigjen ndaj emergjencave të SJT-ve; Tenda me logo për mjedise të jashtme që fryhen me pompë elektrike; Karrocë për Transport; Tabela portative, përfshirë pëlhurën e shtypur për mbulesë; dhe banderola të mbështjella.

Mund të thuhet se edhe shpenzimet prej 2700 USD për një aktivitet janë një investim i madh - afërsisht 18 USD për person (me 150 persona që marrin pjesë në çdo aktivitet). Sidoqoftë, kostot e ndërhyrjes në qasjen “Përshëndetje”, të cilat mund të zvogëlohen

më tej me numrin e njerëzve tek të cilët kemi mbërritur, mund të kompensojnë kërcënimin që paraqesin SJT-të për sistemin shëndetësor, si dhe ekonominë shtëpiake dhe kombëtare.

### Përfundime në lidhje me efektivitetin, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e qasjes “Përshëndetje”

- Qasja “Përshëndetje” është shumë e efektshme në drejtim të mbërritjes pranë një numri të madh personash me anë të mobilizimit të komuniteteve të tëra dhe anëtarëve të të gjitha moshave, nëpërmjet një aktiviteti angazhues dhe me pjesëmarrje për t’u fuqizuar dhe informuar se si të marrin kontrollin e shëndetit të tyre dhe të kenë njohuri dhe mbështetje profesionale për të zvogëluar risqet e parandalueshme që çojnë drejt SJT-ve.



Young and old community members participated in Përshëndetje

- Metoda aftëson shërbimet lokale të KSHP të lidhen me anëtarët e komunitetit - shumë prej të cilëve mund të mos jenë angazhuar kurrë më parë. Gjatë veprimtarisë “Përshëndetje”

**1667 pjesëmarrës u regjistruan pranë Qendrave të tyre Shëndetësore. Meqë 46% e këtyre regjistrimeve të reja janë bërë nga meshkujt,** qasja është premtuese për përfshirjen e këtij segmenti të popullatës të vështirë për t’u mbërritur. Tridhjetë e një përqind e këtyre pjesëmarrësve - midis moshës 14 dhe 89 vjeç (mosha mesatare 36 vjeç) lanë një takim në Qendrën Shëndetësore.

- Vetëvlerësimi i elementit të riskut të SJT-ve është një **faktor shtytës** që individët potencialisht të riskuar ose të prekur nga SJT-të të padiagnostikuara të kenë mundësinë të bëjnë vlerësimin klinik, të kenë trajtimin dhe kujdesin e hershëm dhe shansin të zvogëlojnë paaftësinë dhe vdekshmërinë e parakohshme.
- Qasja **angazhon aktivisht Kabinetet e Promocionit Shëndetësor me komunitetet dhe stafin e KSHP-së në promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve.**
- Qasja është premtuese në drejtim të **përmirësimit të edukimit shëndetësor dhe shanseve për ndryshimin e sjelljes.** Nga një kampion i rastësishëm prej 936 pjesëmarrësish që largoheshin nga aktivitetet e fushatës “Përshëndetje”, **96% u shprehën se kishin mësuar diçka të re për shëndetin që nuk e dinin më parë, ndërsa 93% shprehën qëllimin për të adoptuar të paktën një nga sjelljet shëndetësore që mësuan në aktivitet.**
- **Komunitete të tëra mund të mbërrihen, të vetëvlerësohen, t’u bëhet diagnoza klinike dhe të marrin trajtim brenda një aktiviteti gjysmë dite me 20 punonjës shëndetësorë ose më pak.**
- **Shkollat janë arena të rëndësishme e shërbejnë si kanale komunikuese për të përgatitur komunitetet rreth aktiviteteve të ardhshme.** Nga përvoja, HAP konstatoi se oborret e shkollave ishin ambiente të mira për të zhvilluar aktivitetet. Shkollat **kanë gjithashtu potencialin për të luajtur një rol më të rëndësishëm në përdorimin e këtij modeli në kuadër të një formati projekti për mësimdhënie dhe mësimnxënie; janë një mjet me kosto të ulët për organizimin dhe lehtësimin e aktiviteteve në komunitet lidhur me SJT-të dhe shqetësime më të gjëra shëndetësore.**
- Shpenzimet e përsëritura të qasjes “Përshëndetje” mund të ekuilibrohen duke u integruar me fushatën kombëtare të kontrollit bazë shëndetësor.

HAP ka evidentuar një sërë sfidash të lidhura me qëndrueshmërinë përtej ndërhyrjes së projektit. Ato përfshijnë:

- **Njohja në nivelin kombëtar** e vlerës së qasjeve të lëvizshme dhe komunikimit ballë për ballë për të përfshirë komunitetet, veçanërisht të rinjtë, në fushatat parandaluese të SJT-ve duhet zgjeruar [ër të mbështetur qasjen “Përshëndetje”. Është e rëndësishme që baza e njohurive të kësaj qasjeje të ruhet, të përditësohet dhe të forcohet me kalimin e kohës brenda Institutit të Shëndetit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë.
- Parashikimi në buxhetim dhe kostoja. Është i nevojshëm **angazhimi i fortë politik për të përforcuar potencialin e promovimit të shëndetit në trajtimin e kërcënimeve të paraqitura nga SJT-të në Shqipëri, dhe qasja” Përshëndetje”, megjithëse premtuese, kërkon mbështetje financiare përtej asaj të alokuar më parë nga qeveria për promovimin e shëndetit.**
- Ashtu si me çdo qasje për të mbërritur tek publiku, “Përshëndetje” kërkon kompetencë dhe angazhim në drejtim të logjistikës, transportit dhe magazinimit të pajisjeve, çka mund të komplikohet nga kushtet e rrugëve në zona të largëta që rëndohen nga moti. **Partnerët kompetentë zbatues lokalë luajnë një rol vendimtar në daljen me sukses falë njohurive dhe rrjeteve të tyre lokale, lidhjes me autoritetet lokale, Qendrat Shëndetësore, shkollat dhe grupet e interesit.** Kjo bëhet tejet e rëndësishme në kushte të vështira kur duhet të negociohen ndryshime të minutës së fundit për shkak të motit të paparashikuar ose vështirësive të transportit.
- Ndërsa Shqipëria gjendet brenda një tranzicioni epidemiologjik nga një model i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë si rezultat i sëmundjeve infektive drejt modelit të sëmundjeve jo të transmetueshme, ekziston nevoja për të **forcuar bazën kombëtare të aftësive.** Ekspertiza për promovimin e shëndetit në përgjithësi është shumë e dobët, siç janë edhe kapacitetet për adresimin e SJT-ve, si nga këndvështrimi i parandalimit, ashtu edhe nga i menaxhimit. Qëndrueshmëria e promovimit të shëndetit të komunitetit do të kërkojë investime kombëtare në drejtim të ushqyerjes, çka mungon aktualisht. Mjekët, infermierët dhe punonjësit e tjerë të kujdesit

shëndetësor kanë nevojë për **ngritje të kapaciteteve në drejtim të diagnostikimit të hershëm dhe trajtimit të gjendjeve të tilla si hipertensioni, diabeti dhe faza para diabetit, sëmundja obstruktive pulmonare, mbipesha dhe obeziteti.**

- Roli i **infermierëve** është thelbësor për promovimin e shëndetit dhe parandalimin e SJT-ve, pasi ata së bashku me **punonjësit e kujdesit shëndetësor në komunitet** janë hallka lidhëse kryesore me komunitetet. Ata janë të mirëmotivuar dhe do të jenë thelbësorë për qëndrueshmërinë dhe zgjerimin e qasjeve në komunitet për uljen e rrezikut të SJT-ve, zbulimin e hershëm dhe mbështetjen e trajtimit.

### **Mësimet e nxjerra dhe rekomandimet e politikave për të orientuar përgjigjet e ardhshme ndaj promovimit të shëndetit në drejtim të SJT-ve**

- Gjatë gjithë Fazës 1, HAP evidentoi se personelit të Qendrave Shëndetësore u mungon trajnimi, dokumentacioni orientues dhe materialet e komunikimit për të adresuar me efektivitet SJT-të në komunitet. Për këtë arsye, personi ndihet i papërgatitur për të udhëhequr veprimet parandaluese në komunitet dhe për të dhënë përgjigjen e përshtatshme klinike. Personeli i Qendrave Shëndetësore ishte shumë i angazhuar në aktivitetet e fushatës “Përshëndetje” në komunitetet ku shërben. Personeli tha në komentet e tij se përgatitja dhe angazhimi në një aktivitet të rëndësishëm në komunitet kishte ndërtuar kapacitetet dhe kishte qenë motivues. Ai kishte plotësuar nevojat e personelit për krijimin e kërkesës në kuadër të fushatës kombëtare të kontrollit shëndetësor bazë dhe kishte forcuar burimet dhe kompetencat e tij për të promovuar shëndetin me pjesëmarrje, për të adresuar rritjen e SJT-ve nëpërmjet parandalimit dhe diagnostikimit të hershëm dhe trajtimit. **Në kuadër të mandatit të tij, HAP ka mbushur disa boshllëqe në mbështetjen dhe ndërtimin e kapaciteteve të sistemit KSHP në lidhje me SJT-të, megjithatë, orientime, materiale dhe trajnime të tjera janë të nevojshme nëpër Qendrat Shëndetësore.**



- “Përshëndetje” paraqiti një mundësi të mirë për **Kabinet e Promocionit Shëndetësor** brenda Drejtorive të Shëndetit Publik që ato të përfshihen në ndërhyrjet e para në komunitet me mbështetje teknike dhe materiale nga HAP. Kjo i **forcoi aftësitë e tyre planifikuese dhe besueshmërinë në zbatimin e nismave me pjesëmarrje të komunitetit** bazuar në trajnimet e hershme të HAP-it ku kishin marrë pjesë. **Meqë i njëjti personel do të ëndrojë brenda “njësive vendore të shërbimit shëndetësor”** në kuadër të reformës së shërbimit shëndetësor, Operatorët Rajonalë duhet të luajnë një rol të rëndësishëm drejtues në organizimin e aktiviteteve dhe fushatave të promovimit të shëndetit sipas zonave gjeografike përkatëse.
- U vërejt se aktivitetet e kujdesit shëndetësor ofrojnë një **arenë mjaft të efektshme për angazhimin e adoleshentëve dhe të rinjve**. Pjesëmarrja e kësaj popullate ishte e lartë pasi të rinjve iu dukën tërheqëse takimet ballë për ballë dhe qasja me pjesëmarrje (në krahasim me një fushatë edukimi shëndetësor me orientimin nga lart poshtë). Zhvillimi i shumicës së aktiviteteve në ambientet e shkollës, bëri që të rinjtë të ishin në qendër të informacionit ende pa u promovuar ai.



Participants discussing their self-assessments with Health Centre staff and making follow-up appointments.

- Modeli “Përshëndetje” ofron mundësinë të integrohen në **mësimdhënien e shëndetit në shkollë dhe në projekte; dhe një projekt pilot mund të përcaktojë nëse nxënësit e klasave të larta mund të bëhen transmetues të efektshëm të ndryshimit duke paraqitur një version të kësaj qasjeje në komunitetet e tyre**. Kjo do të sillje përfitime në drejtim të angazhimit gjithëpërfshirës në njohuritë, informacionin dhe parandalimin e SJT-ve për të nxitur sjelljet shëndetësore pozitive qysh në fillim të jetës, si dhe përgatitjen e të rinjve shqiptarë si prindër të ardhshëm në fusha të tilla si: ushqyerja dhe shmangia e duhanpirjes, për shembull. Kjo jo vetëm që do të përfitojë nga potenciali i të rinjve si lehtësues të efektshëm të ndryshimit, por do të forcojë gjithashtu informimin shëndetësor të një popullate kyçe. Nëse një projekt pilot vërtetohet se kjo përshtatje është e efektshme, ajo do të shërbente dhe si një mjet për të **zvogëluar koston e zgjerimit të “Përshëndetjes”**.



- Nuk duhet të nënvlerësohet sesa **pak informacion shëndetësor mbi SJT-të ekziston në zonat rurale të Shqipërisë në lidhje me risqet shëndetësore dhe praktikat pozitive**. Disa të rinj kanë komentuar se kur morën pjesë në “Përshëndetje”, dëgjuan për herë të parë mesazhe në lidhje me ndikimet negative shëndetësore të pijeve të gazuara me sheqer të shtuar. Për më tepër, shumë të rinj nuk pinin ujë dhe nuk ishin të vetëdijshëm për rëndësinë

- e konsumimit të frutave dhe perimeve. Duke pasur parasysh se një sërë modelesh negative të konsumit janë krijuar tashmë mes të rinjve shqiptarë, duhet të shqyrtohen forma të reja, siç është reklamimi i sportistëve dhe muzikantëve të famshëm si kampionë të aktivitetit fizik dhe ushqyerjes pozitive për të ndryshuar zakonet e të rinjve, në mënyrë që të mos rrezikojnë shëndetin e tyre ose atë të fëmijët e tyre në të ardhmen e afërt.
- Ishte hera e parë që pranë komuniteteve të thella vinin shërbimet shëndetësore me anë të modelit me pjesëmarrjen e komunitetit dhe ballë për ballë ku njerëzit nuk konsideroheshin si pacientë. Disa persona, **falë këtij aktiviteti, kontaktuan për herë të parë me Qendrat e tyre Shëndetësore lokale.** Në epokën e SJT-ve, ky kontakt dhe angazhimi parandalues është një pika e fillesës së parandalimit, zbulimit të

hershëm dhe trajtimit për të zvogëluar nivelin e sëmundshmërisë, paaftësisë dhe vdekjeve të parakohshme.

- Si risi, qasja “Përshëndetje” do të përfitonte nga **kërkimi operacional për të zbuluar informacion për metodologjinë dhe metodën që duhet aplikuar veçanërisht për pjesëtarë të caktuar të komunitetit.** Për shembull, disa pjesëmarrës komentuan se nuk mund t’u kërkoni burrave apo pleqve të shtëpisë të mos pinin duhan në dhomën ku rrinin fëmijët. Studimet nga sa më afër, mund të zbulojnë informacione sesi meshkujt, femrat dhe breznitë mund t’i përshtaten modelit për të kapërcyer pengesa të tilla e për të zvogëluar ekspozimin pasiv ndaj tymit të duhanit, për shembull. Duhet të bëhen, **të dokumentohen dhe shpërndahen** çështje të tilla si efektiviteti i kostos i krahasuar me ndërhyrjet e tjera.



i <http://www.thelancet.com/gbd/2015>

ii <http://www.healthdata.org/albania>

#### Për më shumë informacion:

Profesor Kaspar Wyss  
Drejtor, TPH zviceran

[kaspar.wyss@swisstph.ch](mailto:kaspar.wyss@swisstph.ch)

website: <http://www.hap.org.al/?lang=en>

Scan the QR code to watch a short video on the PerSHENDETje campaign.

